

**20250310731**

Në bazë të nenit 52 paragrafi 2 të Ligjit për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat fillore dhe të mesme (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 161/19), ministrja e Arsimit dhe e Shkencës, miratoi

## **PROGRAMIN PËR TRAJNIME DHE AFTËSIM PROFESIONALË TË BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONAL PËR VITIN 2025**

### Neni 1

Me këtë program përcaktohen trajnimet për aftësim profesional të bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2025.

### Neni 2

Trajnimet për përkryerje profesionale të bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2025 janë nga fushat, nënfushat dhe temat e trajnimit:

## **I. PËR SHKOLLAT FILLORE**

### 1. FUSHA: Puna me nxënësit

Nënfusha: Orientimi profesional dhe në karrierë i nxënësve

Tema:

- Orientimi profesional i nxënësve: përforsimi i nxënësve përmes vetëdijesimit dhe këshillimit për zhvillimin në karrierë dhe

- Njohja dhe të kuptuarit e qasjeve të ndryshme për përkrahjen dhe intervenimin (teknikat kognitive – biheviore për zgjidhjen e problemit, qasjet transakcionuese, qasjet sistematike familjare e ngjashëm).

- Përforsimi I shkathtësive të bashkëpunëtorëve profesional për këshillimin e orientimit profesional dhe në karrierë të nxënësit (programi me përparësi)

### 2. FUSHA: Punë me mësimdhënësit

Nënfusha: Mbështetja e mësimdhënësve në punën me nxënësit

Tema:

- Zhvillimi i aftësive sociale dhe i vetëbesimit të nxënësit, përballja me sjelljet problematike dhe krijimi i klimës pozitive socio-emocionale në orë.

### 3. FUSHA: Punë me prindërit

- Nënfusha: Përfshirja e prindërve në jetën dhe punën e shkollës

Tema:

- Bashkëpunimi mes familjes dhe shkollës në parandalimin e dhunës së bashkëmoshatarëve, dhunës kibernetike etj.

### 4. FUSHA: Bashkëpunimi me bashkësinë

Nënfusha: Bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat profesionale

- Arsimi gjithëpërfshirës (inkluziv) në praktikë.

## **II. PËR SHKOLLAT E MESME**

### 1. FUSHA: Puna me nxënësit

Nënfusha: Mbështetja e nxënësve në mësim

Temat:

- Strategjitë, metodat dhe teknikat e të nxënit që kontribuojnë në tejkalimin e vështirësive në lexim, shkrim dhe matematikë.

- Njohja dhe kuptimi i qasjeve të ndryshme ndaj mbështetjes dhe ndërhyrjeve (teknikat njohëse-sjellëse të zgjidhjes së problemeve, qasjet transaksionale, qasjet e sistemit familjar, etj.).

Nënfusha: Përcjellja dhe përkrahja e zhvillimit të nxënësve

Tema:

Qasjet e ndryshme për punën e nxënësve me sjellje problematike.

Nënfusha: Orientimi profesional dhe në karrierë i nxënësve

Tema:

- Përforcimi i shkathtësive të bashkëpunëtorëve profesional për këshillim për orientim profesional dhe në karrierë të nxënësit (program me përparësi).

### Neni 3

Ky program hyn në fuqi ditën vijuese nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 18-2732/2  
10.2.2025  
Shkup

Ministre e Arsimit dhe e  
Shkencës,  
Prof. Dr. **Vesna Janevska**, d.v.